



MINISTRIA E BRENDSHME

AAPSK

AGJENCIA E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE
TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA

AGJENCIA E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE
TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA

AAPSK

**RAPORTI
VJETOR**

2024

PUBLIKUAR MARS 2025




MINISTRIA E BRENDSHME

AAPSK

AGJENCIA E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE
TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA

PËRMBAJTJA

HYRJE	5
MESAZHI I KRYEADMINISTRATORIT	6
QËLLIMI I VEPRIMTARISË SË AAPSK.....	8
Statusi.....	8
Misioni	8
Fokus.....	9
Objektivat.....	9
TË DHËNA STATISTIKORE PËR PASURITË NË ADMINISTRIM TË AAPSK-së	10
Pasuri/prova materiale në administrim të AAPSK	10
Pasuri sipas llojit	10
Pasuri të marra në administrim gjatë vitit 2024.....	10
Pasuri të pamarra në dorëzim.....	10
SEKTORI I ADMINISTRIMIT EKONOMIKO-FINANCIAR TË PASURIVE	11
Të ardhurat	11
Shpenzimet	15
SEKTORI I FINANCËS DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE	18
Monitorimi i buxhetit për vitin 2024	18
Prokurimet për vitin 2024	19
Burimet njërezore	19
SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME INSTITUCIONET DHE ÇËSHTJET JURIDIKE.....	20
Vendime të administruara në AAPSK	20
KNEMKKO.....	20
Çështje në proces gjyqësor me palë AAPSK	21
NISMA RREGULLATORE DHE RRITJE TRANSPARENCE.....	21
PROJEKTE TË TJERA QË MBËSHTESIN SHOQËRINË.....	22
BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET LIGJZBATUESE	26
PROCESI I INTEGRIMIT DHE REKOMANDIMET E INSTITUCIONEVE NDËRKOMBËTARE.....	27
BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR.....	27
PRIORITETE DHE OBJEKTIVA PËR PERIUDHËN NË VAZHDIM	28



HYRJE

Ky raport pasqyron veprimtarinë dhe angazhimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK) përgjatë vitit 2024, në përmbushje të funksioneve dhe përgjegjësi ligjore, duke u bazuar në të dhëna statistikore.

Raporti vjetor i AAPSK-së shërben si një urë komunikimi për të përcjellë në mënyrë transparente informacion mbi administrimin e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara, si edhe punën voluminoze të stafit të Agjencisë, për publikun e gjerë, si edhe në veçanti për personat e interesuar.

Ky raport është hartuar në zbatim të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikëve nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 70, datë 27.04.2017 dhe ligjit nr. 34, datë 04.07.2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”, i ndryshuar. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara ka përcaktuar në mënyrë të qartë strategjitë dhe objektivat afatshkurtër dhe afatmesëm për të përmbushur në mënyrë të plotë misionin dhe vizionin e saj.

Objektivi kryesor i AAPSK-së është rritja e mirëadministrimit të pasurive, duke aplikuar standardet më të mira evropiane. Detyra e saj është të risë të ardhurat nga portofoli i pasurive që ka nën administrim si dhe të ndërgjegjësojë publikun e gjerë mbi rëndësinë e të drejtave dhe mundësive që përfitohen nga administrimi i këtyre pasurive dhe të ardhurat që vijnë prej tyre.

Të mirat dhe përfitimet që burojnë nga këto pasuri të sekuestruara apo të konfiskuara, janë faktorë nxitës për zhvillimin e veprimtarisë së organeve të pavarura të drejtësisë, sjellin përfitime direkte për shtresat vulnerabël, për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe ndihmojnë në vendosjen e konkurrencës në tregun e lirë, duke i kthyer pasuritë e sekuestruara ose konfiskuara në kontributorë të rritjes ekonomike të vendit, bazuar në parimet e “ligjshmërisë” dhe “barazisë”.

Është kjo arsyeja themelore përse është tejet e rëndësishme të ngrihet një sistem kombëtar funksional dhe i besueshëm i administrimit të pronës së sekuestruar apo/dhe të konfiskuar nga strukturat shtetërore, i cili krijon një mjedis stimulues, ku bizneset, industritë dhe individët ndihen të sigurt se puna dhe investimi i tyre janë të bazuara në një sistem të drejtë dhe të fortë administrimi. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) përbën një hallkë kyçe të këtij sistemi, pasi është i vetmi institucion që shërben si strukturë lidhëse mes organeve të drejtësisë dhe shoqërisë (biznese apo individë), për çështjet që i takojnë menaxhimit të pronës së sekuestruar dhe/ose konfiskuar.

Komisioni Europian, në “Kapitullin 23 dhe 24” të Raportit të vitit 2024 për Republikën e Shqipërisë, ndër të tjera është shprehur se “Shqipëria duhet të harmonizojë më tej statistikën dhe raportet e saj me institucionet ligjvënëse, përsa i përket pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara, si dhe vlerën e tyre në treg. Shpenzimet që këto pasuri mbartin, krijimin e një regjistri kombëtar për evidentimin e vendimeve (ligji mbi bazën e të cilit është marrë), llojin e pasurisë dhe vlerën përkatëse”.

Duke marrë në konsideratë rekomandimet e raportit të KE-së, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, me vendosmëri dhe përkushtim, do të vazhdojë të çojë përpara zhvillimin e bashkëpunimeve dhe negociatave, me të gjithë aktorët dhe grupet e interesit në këtë fushë, për të përmbushur jo vetëm misionin e saj, por edhe për të nxitur zhvillimin e pronës së sekuestruar / konfiskuar, për më shumë përfitime për ekonominë e vendit dhe qytetarët.

MESAZHI I KRYEADMINISTRATORIT

I nderuar lexues, përmes publikimit të Raportit Vjetor të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, kam kënaqësinë të ndaj me ju punën dhe veprimtarinë e kryer prej këtij institucioni gjatë vitit 2024.

Ky raport është një mjet i rëndësishëm transparence dhe llogaridhënieje, përmes të cilit Agjencia që unë drejtoj synon të paraqesë rezultatet dhe punën e kryer përgjatë harkut kohor të këtij viti kalendarik. Viti 2024 është mbyllur me rezultate pozitive për Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Sfida jonë është që bazuar mbi këto rezultate, të kalojmë në një nivel edhe më të lartë profesional dhe menaxherial.

Shifrat e këtij viti janë pasqyrim i punës së palodhur për ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e menaxhimit me eficiencë dhe efikasitet të pasurive nën administrim, jo vetëm për aktorët vendas, por edhe aktorët e huaj, që kanë treguar interes për tregun shqiptar. Dua të nënvizoj gjithashtu, se rezultatet janë reflektim i punës së të gjitha institucioneve të përfshira në sistemin e drejtësisë, të cilët kanë luajtur një rol kyç në përmbushjen me sukses të detyrave tona.

Më lejoni të ndaj me ju disa nga arritjet kryesore të institucionit. AAPSK i ofron shërbimet e saj direkt në vendndodhjen e pasurisë. Reduktimi i kohës së protokollimit dhe marrjes në dorëzim të akteve administrative pasi ato janë përcjellë nga organi i akuzës, si dhe i qarkullimit të tyre brenda institucionit edhe në formë elektronike, e shkurttoi ndjeshëm afatin e ekzekutimit dhe rrjedhimisht përshpejtoi marrjen në dorëzim të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. Tashmë të gjitha aktet administrative të administruara apo të hartuara në AAPSK, janë duke u digjitalizuar dhe administratorët apo palët e interesuara mund t'i aksesojnë ato në kohë reale, pa krijuar ngarkesë në zyrën e protokoll / arkivës.

Gjithashtu, për herë të parë në historinë e institucionit, AAPSK, inventarizoi, përpunoi dhe publikoi të plotë të gjitha pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara. Pasuritë janë publikuar në faqen zyrtare të institucionit, e cila gjithashtu për më shumë interaktivitet, transparencë dhe informacion me publikun e gjerë u krijua nga fillimi. Faqja zyrtare e AAPSK përditësohet në mënyrë periodike me informacion, ndërkohë që edhe rrjetet sociale të Agjencisë shërbejnë si një burim shumë i mirë informacioni, edhe për pasuritë nën administrim.

Në kuadër të forcimit të marrëdhënieve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, AAPSK rëndësi të veçantë i ka kushtuar bashkëpunimeve me partnerët në fushën e administrimit të pasurisë, me qëllim forcimin e bashkëpunimit sipas fushës së përgjegjësisë, organizimin e tryezave të përbashkëta me fokus kryesor ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi efikasitetin e luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, ritjen e mirëmenaxhimit të pronës së sekuestruar, vënien e këtyre pasurive në funksion të komunitetit, përmirësimin e strukturave për të përmbushur në mënyrë më cilësore standardet evropiane, etj. Agjencia ka mbajtur një komunikim të hapur me homologët ndërkombëtarë, si edhe ka forcuar më tej marrëdhëniet me vendet anëtare të BAMIN.



Një falënderim për të gjitha institucionet partnere, institucionet në nivel kombëtar të përfshira në sistemin e pronësisë të sekuestruar dhe konfiskuar dhe anëtarët e grupit ndërinstitucional të punës së Kapitullit 23 (gjyqësori dhe të drejtat themelore) dhe Kapitullit 24 (drejtësia, liria dhe siguria), përfaqësuesit e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, si dhe grupin ndërinstitucional të punës për përmbushjen e rekomandimeve të MONEYAL.

Mirënjohje për Organizatat Ndërkombëtare, Partners Albania, Zyrën e Këshillit të Europës, GIZ, OSBE, të cilët bashkëpunojnë dhe mbështesin në vijimësi Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, duke qënë pjesë e projekteve të përbashkëta, si dhe duke asistuar përmes ekspertizës në rritjen e kapaciteteve profesionale.

AAPSK mbetet e hapur dhe aktive për të dhënë kontributin e saj në fushën e menaxhimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. Fokusi ynë mbetet menaxhimi me efektivitet i pasurive nën administrim, duke vepruar në interesin më të lartë të shtetit.

Në përfundim, falenderoj stafin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, të cilët me përkushtim dhe këmbëngulje arritën të përmbushin në kohë të gjitha prioritetet dhe objektivat e vendosura për vitin 2024, ndërsa përpara tani kemi një tjetër vit sfidues 2025.

Me respekt,



KRYEADMINISTRATOR

QËLLIMI I VEPRIMTARISË SË AAPSK

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) është krijuar në zbatim të ligjit nr. 9284, datë 30.09.2004 *“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”*.

AAPSK është institucioni përgjegjës për administrimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të cilat sekuestrohen dhe/ose konfiskohen nga sistemi gjyqësor apo organi i akuzës.

Nga ana jonë po punohet në mënyrë të vazhdueshme për përmirësimin e praktikave të punës në administrimin e pasurive të cilat përbëjnë portofolin e Agjencisë, pasurimin e bazës ligjore me akte të cilat do të sillnin eficiencë në administrimin e pasurive të sekuestruara/konfiskuara, duke miratuar rregulloren e brendshme, hartimi i manualeve dhe katalogëve të pasurive që AAPSK administron, si dhe propozimet për ndryshime ligjore në lidhje me procedurat e shitjes së pasurive të konfiskuara dhe përdorimin e një pjese të fondit si kontribut socio – ekonomik në të mirë të komunitetit.

STATUSI

Veprimtaria, organizimi, funksionimi, kompetencat dhe përgjegjësitë e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, si person juridik publik, buxhetor, në varësi të Ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, rregullohen sipas përcaktimeve ligjore të ligjit nr. 10 192/2009 *“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”* i ndryshuar, dhe ligjit nr.34/2019 *“Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”* i ndryshuar, si dhe akteve të tjera nënligjore të nxjerra në zbatim të këtyre ligjeve.

Agjencia shërben si pika fundore e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore me objekt sekuestrimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, deri në momentin e marrjes së formës së prerë të vendimit, i cili vendos revokimin apo konfiskimin dhe më pas, sipas rastit kalimin në favor të shtetit të këtyre pasurive. Roli i agjencisë shërben si një hallkë mjaft e rëndësishme në gjithë zinxhirin e ekzekutimit të vendimit.

MISIONI

AAPSK është e përkushtuar të sigurojë menaxhim dhe administrim efektiv të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, duke mbështetur përpjekjet e zbatimit të ligjit për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin, si dhe promovimin e transparencës dhe llogaridhënies, për të garantuar të njëjtin nivel administrimi me praktikat më të mira të vendeve të Bashkimit Europian.

Kjo përfshin:

- » **Ruajtjen dhe mirëmbajtjen** e pasurive për të garantuar vlerën e tyre;
- » **Shndërrimin e pasurive** në të ardhura publike ose përdorimin e tyre për qëllime të dobishme;
- » **Mbështetjen e sistemit të drejtësisë** për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin;
- » **Gjithëpërfshirje** për të qënë motor zhvillimi e promovimi i projekteve që sjellin eficiencë dhe efektivitet në proceset e administrimit.

FOKUSI

Fokusi kryesor i Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) është administrimi efektiv dhe transparent i pasurive që janë sekuestruar ose konfiskuar sipas ligjit. Ky administrim konsiston në:

- » **Të sigurojmë që vlera e pasurive të mos degradohet;**
- » **Përdorimin strategjik dhe të ligjshëm** të këtyre pasurive në mënyrë që të kontribuojnë në financimin publik ose për qëllime të dobishme;
- » **Mbështetjen e sistemit të drejtësisë** për të siguruar që pasuritë të përdoren në përputhje me ligjin dhe normat etike;
- » **Sigurimin e transparencës** për t'i dhënë besim publikut se këto pasuri administrohen në mënyrë të drejtë dhe efikase.

Në fokusin e AAPSK-së është përmirësimi i funksionimit të regjistrit elektronik të të dhënave për pasuritë e sekuestruara/konfiskuara, me qëllim gjenerimin e të dhënave statistikore për të gjithë institucionet dhe publikun e gjerë. Ky sistem shërben si një mjet për të garantuar transparencë të plotë mbi të gjitha pasuritë nën administrim. Një aspekt i rëndësishëm i punës së AAPSK është edhe shndërrimi i pasurive në të ardhura publike, gjë e cila ka dy qëllime:

- » **Goditja e krimit të organizuar**, duke i hequr fitimet e paligjshme.
- » **Rritjen e kontributit financiar në buxhetin e shtetit**, që ndikon në mbështetjen e projekteve sociale ose ekonomike.

OBJEKTIVAT

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) ka si objektiv kryesor administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kjo përfshin:

- » Mirëmenaxhimin e pasurive për të rritur vlerën e tyre financiare;
- » Zbatimin e procedurave ligjore për administrimin e pasurive;
- » Sigurimin e transparencës dhe efikasitetit në përdorimin e fondeve publike;
- » Dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e procesit të administrimit.

Ndër objektivat e tjera të Agjencisë janë edhe:

- » Forcimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, me qëllim aplikimin e modeleve të suksesshme sa i përket projekteve me impakt social, rritjes së mbështetjes për institucionet e pavarura të drejtësisë, si edhe përmirësimin e mëtejshëm të administrimit të pasurive;
- » Tejkalmimi me sukses i sfidave dhe implementimi i “Strategjisë Kombëtare të Luftës kundër Trafikimit Njerëzor 2024-2025”, konkretisht përmes përkrahjes së viktimave të trafikut të qënieve njerëzor dhe rritjes së ndërgjegjësimit të komunitetit nëpërmjet fushatave sensibilizuese.

TË DHËNA STATISTIKORE PËR PASURITË NË ADMINISTRIM TË AAPSK

Më poshtë gjendet pasqyra e të dhënave mbi numrin e pasurive në administrim të AAPSK-së, të ndara në pasuri të sekuestruara dhe konfiskuara, prova materiale dhe llogari bankare sipas gjendjes deri më 31.12.2024:

Pasuri/Prova materiale sipas vendimeve gjyqësore		
Nr.	Përshkrimi	Total
1	Pasuri/ Prova materiale sipas vendimeve	2,562
2	Pasuri/ Prova materiale të marra në dorëzim	1799
3	Pasuri/ Prova materiale të pamarra në dorëzim	763

Pasuri/Prova materiale në administrim të AAPSK-së deri më 31.12.2024:

Pasuri në administrim të AAPSK		
Nr.	Përshkrimi	Total
1	Të Sekuestruara	1060
2	Të Konfiskuara	434
3	Prova materiale	228
4	Llogari/shuma monetare të konfiskuara të arkëtuara në llogari të dedikuara të AAPSK	77
	TOTAL	1799

Pasuri/Prova materiale në administrim të AAPSK-së sipas llojit deri më 31.12.2024:

Pasuri në administrim të AAPSK sipas llojit				
Nr.	Kategoria	Përshkrimi	Statusi	Total
1	Pasuri të paluajtshme	Apartamente/Ndërtesa/Objekte/Parkim/Garazh	Sekuestruar	356
			Konfiskuar	278
		Tokë truall/Arë/Pyje/Kullota	Sekuestruar	90
			Konfiskuar	105
2	Pasuri të luajtshme	Automjete/Mjete motorike/Asete të luajtshme	Sekuestruar	125
			Konfiskuar	31
3		Subjekte tregtare (Person fizik/Juridik)	Sekuestruar	104
			Konfiskuar	20
4		Llogari bankare/Shuma monetare	Sekuestruar	385
			Konfiskuar	77
5		Prova materiale	Sekuestruar/ Konfiskuar	228
		TOTAL		1799

Pasuritë e marra në administrim sipas llojit gjatë vitit 2024:

Pasuri në administrim të AAPSK sipas llojit				
Nr.	Kategoria	Përshkrimi	Statusi	Total
1	Pasuri të paluajtshme	Apartamente/Ndërtesa/Objekte/	Sekuestruar	127
			Konfiskuar	97
		Tokë truall/Arë/Pyje/Kullota	Sekuestruar	28
			Konfiskuar	10
2	Pasuri të luajtshme	Automjete/Mjete motorike/Asete të luajtshme	Sekuestruar	63
			Konfiskuar	12
3		Subjekte tregtare (Person fizik/Juridik)	Sekuestruar	57
			Konfiskuar	2
4		Llogari bankare/Shuma monetare	Sekuestruar	277
			Konfiskuar	26
5		Prova materiale	Sekuestruar/ Konfiskuar	113
TOTAL				812

Pasuri të pamarra në dorëzim:

Për pasuritë dhe provat materiale të cilat ende nuk i janë dorëzuar AAPSK-së sipas vendimeve të gjykatave kryesisht, janë hasur problematikat:

- » Për objektet e banimit, kryesisht në këto ambjente jetojnë familjarë të cilët nuk kanë banesa të tjera për të jetuar;
- » Për mjetet motorike nuk është identifikuar vendndodhja e tyre dhe janë shpallur në kërkim nga policia;
- » Për subjektet tregtare nuk bëhet i mundur identifikimi i selisë së tyre dhe vendi i ushtrimit të aktivitetit, sepse nuk kanë aktivitet dhe figurojnë me status pasiv në QKB;

Totali i pasurive të pamarra në dorëzim është 763 pasuri/prova materiale.

SEKTORI I ADMINISTRIMIT EKONOMIKO – FINANCIAR TË PASURIVE

Të ardhurat

Totali i të ardhurave nga qiratë **për vitin 2024 është 159,139,500 lekë**. AAPSK gjatë vitit 2024, kishte në administrim 282 pasuri të sekuestruara/konfiskuara të dhëna me qira dhe nga vjelja e qirave, ka arkëtuar **159,139,500** ose 80% të totalit të ardhurave të Agjencisë. Në vitin 2023, AAPSK kishte dhënë me qera 198 pasuri të sekuestruara/konfiskuara dhe nga vjelja e qirave arkëtoi 78,902,024 lekë. Nga krahasimi me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, rritja e të ardhurave nga pasuritë e dhëna me qira është (+80,237,476) lekë, ose 97% më shumë se një vit më parë. Ky tregues është mjaft domethënës sa i përket rritjes së mirëadministrimit të


pasurive dhe përmirësimit të treguesve financiarë të AAPSK. Të gjitha pasuritë e sekuestruara dhe konfiskuara, janë publikuar për dhënie me qira, por kërkesat për marrje me qira kanë qenë të kufizuara më disa raste dhe për pasuri të caktuara nuk ka patur shprehje interesi, kjo edhe për shkak të specifikave që kanë disa nga pasuritë e sekuestruara dhe konfiskuara.

Në tabelën e mëposhtme jepet numri i pasurive të dhëna me qira, për vitet 2020, 2021, 2022, 2023 dhe 2024:

Pasuritë e dhëna me qira dhe të ardhurat në vite		
Vitet	Numri i pasurive të dhëna me qira	Të ardhurat nga qiratë në lekë
2020	65	15,376,893
2021	146	50,336,224
2022	170	74,981,046
2023	198	78,902,024
2024	282	159,139,500

Rritja e të ardhurave nga qiratë është siguruar përmes rritjes së angazhimit të stafit të Agjencisë dhe administratorëve, përmes publikimeve të herëpashershme të pasurive në faqen zyrtare të AAPSK, si edhe rritjes së interaktivitetit të Agjencisë dhe kanaleve të komunikimit në rrjetet sociale.

Numri i pasurive të dhëna me qira gjatë viteve dhe vlera e përfituar prej tyre paraqitet grafikisht si më poshtë:



Llogaritë bankare të sekuestruara

Llogaritë bankare të sekuestruara kanë qenë në formën e llogarive rrjedhëse dhe depozitave. Në çdo rast është ndjekur një politikë e qartë e investimit të këtyre pasurive.

Gjatë vitit 2024, janë sekuestruar me vendim gjykatë si prova materiale, 4,053 Dollarë, 27,250 GBP, 160 Franga Zvicerane dhe 255,158 Euro. Po gjatë këtij viti, janë konfiskuar si prova materiale 24,050 Euro dhe 11,463,831 Lekë. Vlerat monetare të sipërcituara kanë kaluar në llogaritë bankare të AAPSK-së me emërtesë “Të ardhura dhe shpenzime nga pasuritë e sekuestruara/konfiskuara”, sipas monedhave respektive.

Gjendja e llogarive depozita deri në datën **31.12.2024**, sipas monedhave të huaja dhe në lekë, paraqitet në pasqyrën e mëposhtme.

Depozita 6/mujore në Euro	Depozita 6/Mujore në USD	Depozita në lekë	Depozita në GBP
5,474,757	200,521	28,316,500	153,540
10,469,854	0	0	0
59,922	0	250,207	0
8,455,203	0	0	0
24,459,736	200,521	28,566,707	153,540

Gjatë vitit 2024, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara ka ripërtërirë kontratat e depozitave bankare 6 mujore me dy banka për depozitimin e shumave respektive 10,469,854 Euro dhe 8,455,203 Euro.

AAPSK ka negociuar me bankat e nivelit të dytë, për të marrë interesa preferenciale, për të gjitha depozitat, duke siguruar në një rast interesin prej 4%, ndërsa në tjetrin norma e interesit është 4.2%, gjithnjë për afatin 6-mujor. Shumat e përfituara nga interesat bankare gjatë vitit ushtrimor 2024, janë rikapitalizuar dhe rifutur në depozita, duke pritur vendimet përfundimtare të Gjykatave për pasuritë e sekuestruara.

Mbështetur në ligjin nr. 34/2019, i ndryshuar, “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara”, mirëadministrimin dhe përdorimin sa më eficient, efektiv dhe ekonomik të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, AAPSK duke ndjekur me vëmendje ndryshimet e zhvillimeve të tregut, ka depozituar këto shuma në euro nga llogari rrjedhëse në depozita me afat 6 mujor, me interesa të leverdisshme.

Fondi i konfiskimit në 31.12.2024 sipas llojit të monedhës paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi	Fondi i konfiskimit në Lekë	Fondi i konfiskimit në Euro	Fondi i konfiskimit në dollarë (USD)
1	Vlera të konfiskuara në lekë, llogaria në Degën e Thesarit, Tiranë	26,603,120		
2	Vlera të konfiskuara në Euro, llogari në bankat tregtare		2,300,000	
3	Vlera të konfiskuara në Dollarë, llogari në bankat tregtare			69,000
4	Vlera të krijuara nga shitja e pasurive në vitet 2023-2024, që ndodhen në llogari dhe depozita, pjesë e fondit të konfiskimit	30,000,000		
	Totali	56,603,120	2,300,000	69,000

Të ardhurat sipas burimit të krijimit të tyre

Të ardhurat sipas burimit të krijimit të tyre jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi	Vlera në lekë	Vlera në %
1	Të ardhura nga dhënia me qira e pasurive të Sekuestruara/Konfiskuara	159,135,500	80%
2	Të ardhura nga shpronësimi i pasurive me vendim të Këshillit Bashkiak, si kompensim i pasurisë së konfiskuar me vendim gjykate	25,411,182	12.8%
3	Të ardhura nga mbajtja e shpenzimeve të kryera ndër vite për pasuritë e shitura me ankand në vitin 2023. (Sipas pikës nr. 28 të vendimit nr. 888, dt. 11.11.2020)	10,637,911	5.36%
4	Të ardhura nga mbajtja e shpenzimeve të kryera për administrimin e pasurive në momentin e revokimit të pasurive	3,169,139	1.84%
	Të ardhura gjithsej	198,353,732	100%

Sikundër shihet edhe nga tabela, zërin kryesor të ardhurave e zënë të ardhurat e krijuara nga dhënia e pasurive me qira dhe të ardhurat e krijuara nga shpronësimi me vendim të Këshillit Bashkiak të Tiranës për pasuri të konfiskuara me vendim gjykate.


Shpenzimet

Në tabelën e mëposhtme jepen shpenzimet analitike. Shpenzimet janë ndarë sipas llojit dhe ndarja e tyre është bërë në lidhje me natyrën e shpenzimit, në përputhje me mirëadministrimin e pronës.

Tabela e shpenzimeve analitike

Nr.	Emërtimi	Vlera në lekë 2023	Vlera në lekë 2024	Vlera në +/- devijimet
1	Shërbimi i rojes së objekteve të sekuestruara/konfiskuara	42,710,442	60,731,747	+18,021,305
2	Shpenzime për sigurim pasurie (ZTE)	1,634,365.0	2,788,600	+1,154,235
3	Shpenzime për pagesë vend parkimi, autovetura të institucionit	0	270,000	+270,000
4	Shpenzime për riparim autoveture	598,108	440,000	-158,108
5	Shpenzime për energji elektrike+ ujë për magazinën me qira të AAPSK	353,291	200,921	-152,370
6	Shpenzime për karrotrec	1,031,800.0	618,200	-413,600
7	Naftë	2,958,921	1,186,620	-2,156,521
8	Dieta	802,400	1,367,440	+565,040
9	Shpenzime për analizë naftë të sekuestruar	30,000	30,000	0
10	Shpenzime për matje të gjendjes së naftës në anije (objekt i sekuestruar)	96,000	0	-96,000
11	Kancelari	247,573	479,937	+232,364
12	Shpenzime për pagesa për ASHK-në (Tarifa pagese sipas VKM për shërbimet e kryera ndaj AAPSK-së)	1,199,200	1,451,000	+ 251,800
13	Pagesë qiraje për magazinë të AAPSK	3,096,000	3,096,000	0
14	Pagesë qiraje për "Shesh magazinimi për kontener"	0	200,000	+ 200,000
15	Pagesë qiraje për stallë bagëtish të sekuestruara	0	1,756,667	+ 1,756,667
16	Pagesa për anëtarët e Komitetit Drejtues Ndërinstitucional	1,377,000	1,343,000	- 34,000
17	Shpenzime për pagesa ekspert të jashtëm për vlerësimin e pasurive të konfiskuara të dërguara për shitje.	781,000.0	70,000	-711,000
18	Shpenzime për pagesa ekspert të jashtëm për vlerësimin e pasurive të sekuestruara, sisteme elektronike (inventarizime)	0	298,000	+298,000
19	Shpenzime për pagesa për ekspert të jashtëm topograf.	1,841,000	98,000	-1,743,000
20	Taksa vendore	851,765	686,580	-165,185
21	Komisione bankare	180,200	173,800	-6,400
22	Pagesë tarife për çelje vendime gjyqësore	0	20,550	+20,550
23	Tatimi në burim për pronat e dhëna me qira dhe tatimi për shpërblim të anëtarëve të Komitetit Drejtues Ndërinstitucional	3,191,103	4,722,942	+1,531,839
24	Pagat + Sigurime shoqërore	25,386,963	36,730,063	+11,343,100
25	Ndihmë financiare	425,000	80,750	-344,250
26	Shpenzime për DPSHTRR (Taksa+Kolaudim)	54,761	0	-54,761
27	Shpenzime përkthimi	8,160	0	-8,160
28	Shpenzime për mirëmbajtje pasurie	426,500	376,300	-50,200
29	Kthim të ardhurash nga revokimi i pasurive		9,727,108	+9,727,108
	Totali	89,281,552	128,944,225	+ 39,662,673

Shpenzimet kryesore të vitit 2024



Mbështetur në Udhëzimin nr. 324, datë 02.10.2020 të Ministrit të Brendshëm „Për përcaktimin e rregullave, procedurave për administrimin e të ardhurave dhe limiteve të kryerjes së shpenzimeve për pasuritë e sekuestruara dhe konfiskuara”, kapitulli i II-të, “Shpenzimet e administrimit të pasurive” pika 2.2 “Shpenzimet për ruajtjen fizike apo digjitale”, AAPSK ka marrë masat për ruajtjen fizike të objekteve të sekuestruara dhe konfiskuara të marra në administrim. AAPSK ka qenë e detyruar të ruajë fizikisht disa pasuri të sekuestruara/ konfiskuara, të cilat për shumë arsye, nuk mund të jepen me qira në mënyrë që të krijojnë të ardhura, por ato vetëm rrisin shpenzimet e ruajtjes së objekteve. Nga tabela shihet se zërin kryesor të shpenzimeve, e zënë shpenzimet për ruajtjen e objekteve të sekuestruara apo të konfiskuara, në shumën prej **60,731,747 lekë ose 47.%** të totalit të shpenzimeve. Në krahasim me vitin 2023, shpenzimet për ruajtjen fizike të pasurive u rriten me 18,021,325 lekë. Kjo rritje shpjegohet me rritjen e numrit të pasurive në administrim, të cilat ruhen me roje fizike nga “Yllirian Guard” Sh.a.

Zërin e dytë kryesor të shpenzimeve e zënë pagat + sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në shumën prej **36,730,063 lekë ose me 28.4 %** të totalit të shpenzimeve. Në krahasim me vitin 2023, shpenzimet për paga dhe sigurime u rriten me 11,343,100 lekë. Kjo rritje argumentohet me rritjen e numrit të administratorëve, për shkak të rritjes së numrit të pasurive në administrim.

Gjatë vitit 2024, është paguar në kohë tatimi në burim (15%) në vlerën 4,722,942 lekë, i krijuar mbi të ardhurat nga pasuritë e dhëna me qira dhe tatimi mbi pagesat e komisioneve që marrin anëtarët e Komitetit Ndërinstitucional për Masat kundër Krimit të Organizuar.

Për mbarëvajtjen e aktivitetit të AAPSK shërben edhe një magazinë e marrë me qira, në të cilën janë të depozituara një pjesë e pasurive të luajtshme të sekuestruara, kryesisht automjete dhe prova materiale në kuadër të zbatimit të Aktit Normativ nr.1 dt 31.01.2020 dhe vendimeve të gjykatave. Vlera e qirasë vjetore për magazinën është 3,096,000 lekë. Në kuadrin e marrjes në administrim të provave materiale mbështetur në vendimet e gjykatave apo në urdhërat e prokurorit, gjatë vitit 2024, AAPSK ka marrë gjithashtu me qira ambjente për ruajtjen e provave materiale si “Stallë bagëtish”, “shesh për magazinimin e konteinerëve” dhe kjo ka sjellë rritje të shpenzimeve, në vlerën 1,956,667 lekë.

Mbështetur në ligjin nr. 34/2019, i ndryshuar, pika 5, neni 21, “Kur vendoset revokimi i sekuestrimit, AAPSK

bën kthimin e kundërvlerës së saj”. Kështu, AAPSK ka kthyer tek pronarët e ligjshëm të ardhurat e krijuara gjatë administrimit të pasurive të dhëna me qira, pasi ka mbajtur shpenzimet e kryera gjatë administrimit të pasurisë. Gjatë vitit 2024, mbështetur në Ligjin 34/2019, i ndryshuar, neni 31, pika 6, vendimeve të Gjykatës së Apelit, janë mbajtur të gjitha shpenzimet e administrimit për pasuritë e sekuestruara, të cilat janë revokuar me vendime gjyqate. Vlera e arkëtuar nga AAPSK për vitin 2024, nga mbajtja e shpenzimeve të administrimit për pasuritë e revokuara, është **3,169,569 lekë**.

Mbështetur në Ligjin 34/2019 i ndryshuar, neni 31, pika 6, Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 324, datë 02.10.2020, “Për përcaktimin e rregullave, procedurave për administrimin e të ardhurave dhe limiteve të kryerjes së shpenzimeve për pasuritë e sekuestruara dhe konfiskuara”, kreu i III-të, “Rregullat për mënyrën dhe mbajtjen dhe evidentimin e shpenzimeve”, pika 3, për çdo pasuri të revokuar janë mbajtur kartelat e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në momentin e revokimit të pasurive sipas rastit për çdo pasuri mbështetur në kartelat e pasurive të mbajtura nga Administratori i pasurisë, janë mbajtur shpenzimet ose janë kthyer të ardhurat, të cilat janë krijuar gjatë administrimit të pasurisë.

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen vlerat e kthyera të krijuara nga administrimi i pasurisë, si dhe shpenzimet e krijuara gjatë administrimit të pasurive, të mbajtura nga AAPSK në momentin e revokimit të pasurive.

Nr.	Përshkrimi i veprimit	Vlera në lekë	Diferenca në lekë+/-
1	Kthim të ardhurash nga revokimi i pasurive të dhëna me qira	9,727,108	
2	Mbajtja e shpenzimeve të kryera gjatë administrimit për pasuritë e revokuara	3,169,569	
	Diferenca		-6,557,539

Me vendim të Komitetit Ndërinstitucional nr.78, datë 23.11.2022, nga të ardhurat e krijuara nga shitja e pasurive të konfiskuara me ankand nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për vitin 2022 kanë kaluar 125,000,000 lekë për përdorim të Agjencisë. Nga kjo, 83,000,000 lekë janë dhënë për ushtrimin e aktivitetit të vitit 2023 për mbulimin e shpenzimeve dhe 42,000,000 lekë për investime, për “rikonstrukcion zyrash dhe blerje paisjesh” për AAPSK. Realizimi i investimeve për vitin 2023 dhe 2024 paraqitet si më poshtë në tabelë.

Realizimi i Investimeve për vitin 2023-2024.

Nr.	Emërtimi	Vlera në lekë me tvsh	Shpallja e fituesit në vlerë me tvsh	Realizimi Vlera në lekë 2023 me tvsh	Vlera në +/- Realizimi Vlera në/000 lekë 2024 me tvsh
	Fondi total për investime për vitin 2023	42,000,000			
1	Fondi për Investime për rikonstrukcion zyrash	26,673,607	18,183,819	14,325,935.4	1,813,217
2	Mobilim zyrash AAPSK	6,823,580	5,322,000	5,322,000.0	0
3	Pajisje kompjuterike, projektor, etj.	9,364,976	7,260,060	7,260,060	0
	Shuma e realizimit të investimeve	42,000,000	30,765,879	26,907,995.40	1,813,217

Investimi ka filluar në vitin 2023 dhe ka përfunduar në vitin 2024. Vlera totale e fondeve ishte 42.000,000 lekë, ndërsa realizimi në total për vitin 2023 dhe 2024 është 28,721,212.00 lekë. Teprica e fondeve rezulton 13,278,788.00 lekë. Kjo tepriçë mund të përdoret për qëllime investimi të zyrave të reja të AAPSK, pasi këto fonde janë të trashëgueshme.

SEKTORI I FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

1. Mbi monitorimin e buxhetit për vitin 2024

Totali i buxhetit për vitin 2024 ka qënë i planifikuar në vlerën 28,797,000.0 lekë dhe është realizuar në fakt 20,727,880.0 lekë. Më poshtë jepet buxheti i miratuar për këtë periudhë, sipas realizimit të zërave përkatës dhe konkretisht:

- » Në zërin paga, llogaria 600, fondi i miratuar në fillim të vitit ishte (18,783,000) lekë, i rishikuar me shtesë fondi në muajin korrik 2024 në shumën (453,000) lekë, si pasojë e zbatimit të VKM nr.325 datë 31.05.2023. Në fund të vitit, plani ishte **(19,236,000) lekë**. Realizimi i buxhetit për këtë zë shpenzimi është **14,066,059.0 lekë**. Mosrealizimi ka ardhur pasi nuk janë plotësuar vendet vakante që AAPSK ka sipas organikës së miratuar.
- » Në zërin sigurime shoqërore, llogaria 601, fondi i miratuar në fillim të vitit ishte (3,091,000) lekë, i rishikuar në muajin korrik 2024 me shtesën (76,000) lekë, si pasojë e zbatimit të VKM nr.325 datë 31.05.2023. Në fund të vitit plani ka qënë **3,167,000.0 lekë**. Realizimi i buxhetit për këtë zë shpenzimi është **2,719,292.0 lekë**. Mosrealizimi ka ardhur pasi nuk janë plotësuar vendet vakante që AAPSK ka sipas organikës së miratuar.
- » Në zërin shpenzime operative, llogaria 602, nuk ka patur ndryshime nga fondi i miratuar në fillim të vitit. Planin për periudhën e monitorimit është **(6,100,000) lekë** dhe realizimi është **(4,283,359) lekë**.
- » Në zërin fondi i veçantë, në fillim të vitit nuk është miratuar fond. Me rishikimin e buxhetit, fondi i veçantë u shtua me **295,000 lekë** dhe u realizua në fund të vitit **261,170 lekë**.

2. Prokurimet për vitin 2024

Mbi bazën e limiteve të fondeve të akorduara AAPSK-së për vitin 2024, është hartuar regjistri i parashikimit të prokurimeve, i cili është publikuar elektronikisht në sistemin e APP.

Për vitin 2024 është hartuar regjistri i parashikimeve të prokurimeve publike ku ishin planifikuar 25 (njëzetë e pesë) procedura, konkretisht 14 blerje me procedure blerje me vlerë të vogël, 9 blerje me vlerë të vogël nën 100,000 lekë, 2 procedura prokurimi e hapur e thjeshtuar, marrëveshje kuadër për t'u realizuar nga Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

Parashikimi për t'u realizuar me fondin limit 16,744,849.46 (gjashtëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e dyzetë e katër mijë e tetëqind e dyzetë e nëntë pikë dyzetë e gjashtë) lekë pa tvsh, konkretisht 4,370,000.00 (katër milionë e treqind e shtatëdhjetë mijë) lekë pa tvsh nga buxheti i shtetit dhe 12,374,849.46 (dymbëdhjetë milionë e treqind e shtatëdhjetë e katër mijë e tetëqind e dyzetë e nëntë pikë dyzetë e gjashtë) lekë pa tvsh nga të ardhurat e agjencisë.

Mbi bazën e këtyre parashikimeve janë realizuar gjithsej 14 (katërmëdhjetë) procedura prokurimi nga ana e AAPSK-së me fond të realizuar 5,635,867.46 (pesë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë dyzetë e gjashtë) lekë pa tvsh dhe 2 (dy) procedura prokurimi nga OBP, konkretisht:

1. *"Furnizim me lëndë djegëse për automjete "Diesel" me vlerë 2,717,640.0 lekë me tvsh.*
2. *"Shërbime topografike për pasuritë e sekuestruara dhe konfiskuara për AAPSK" me vlerë 2,374,560.0 lekë me tvsh.*

3. Burimet njerëzore

Referuar vendimit të Komitetit Ndërinstitucional nr. 59, datë 08.07.2022, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, që nga data 15.11.2023 ushtron aktivitetin e saj në pasurinë me nr. 6/24+1-N4, vol. 42, fq.26 e llojit njësi, me sipërfaqe 392.1 m2 dhe verandë 114 m2 në adresën: Rruga e Kavajës "Kompleksi Delijorgji", Kulla C , Kati 1, H 2, Tiranë. Kjo përmirësoi ndjeshëm cilësinë e punës të administratorëve dhe stafit në AAPSK. Megjithatë shtimi në mënyrë të ndjeshme i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, kërkon rritjen e numrit të administratorëve dhe ndihmës/administratorëve dhe për rrjedhojë përmirësimin e strukturës dhe organikës së AAPSK.

Me qëllim përmirësimin e kushteve të punës në vijim, me vendim të Komitetit, janë shtuar sipërfaqet, ku AAPSK pasi të përfundojë projektin, do të mund të zgjerojë hapësirat e saj të ushtrimit të veprimtarisë së punës.

Konkretisht:

154/23.10.2024	Për kalimin në pronësi të AAPSK të njësisë me sipërfaqe 175 m2, Kompleksi Delijorgji.
155/23.10.2024	Për kalimin në pronësi të AAPSK garazh me sipërfaqe 12.5 m2, Kompleksi Delijorgji.

Në vitin 2024, ndërsa organika e AAPSK nuk ka ndryshuar, për 6 mujorin e dytë të vitit ka mbetur një vend vakant dhe konkretisht pozicioni i specialistit të financës (në sektorin e financë/buxhet/burime njerëzore). Megjithëse janë zhvilluar disa shpallje për këtë vend vakant, përsëri ky pozicion nuk është plotësuar. Në vitin 2025 do të propozohet përmirësimi i strukturës ekzistuese dhe shtimi i organikës së punonjësve me status, për të përballuar shtimin e aktivitetit të AAPSK dhe rritur eficiencën në të ardhmen. Në vitin 2024 kundrejt vitit 2023, pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara të marra në administrim janë rritur me rreth 70% .

Në fillim të vitit 2024 në AAPSK ishin të punësuar me kontratë me Kod Pune 14 administratorë dhe 13 ndihmës administratorë. Gjatë vitit 2024, janë larguar 3 administratorë dhe janë punësuar 6 të tjerë, ndërkohë që janë larguar 5 ndihmës administratorë dhe janë punësuar 3 të tjerë. Në fund të vitit 2024 në AAPSK rezultojnë me kontratë pune 17 administratorë dhe 11 ndihmës administratorë. Rritja e numrit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara kërkon më shumë administratorë dhe staf mbështetës për mirëadministrimin me efikasitet të tyre. Kjo kërkon gjithashtu një riorganizim strukturor të AAPSK dhe modernizimin e saj, duke rekrutuar punonjësve të specializuar dhe të përshtatshëm për realizimin me sukses të kërkesave gjithnjë në rritje të aktivitetit të AAPSK.

Mbështetur në Urdhërin e Kryeadministratorit nr. 878, datë 21.11.2024 “Mbi inventarizimin e pasurive dhe provave materiale të Konfiskuara në administrim të AAPSK”, u ngrit grupi i punës, i cili realizoi inventarizimin e të gjitha pasurive në Administrim të AAPSK-së.

SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME INSTITUCIONET DHE ÇËSHTJET JURIDIKE

1. Vendimet e gjykatave dhe urdhrat administrativë të depozituara në AAPSK

Gjatë vitit 2024 në AAPSK janë administruar 158 vendime gjyqësore dhe urdhra administrativë (të cilët përfshijnë disa lloji tipologjish për pasuri të luajtshme apo të paluajtshme dhe një numër të konsiderueshëm pasurish). Konkretisht këto 158 vendime gjyqësore dhe urdhra administrativë, grupohen në:

- » **28** vendime të marra sipas ligjit nr. 10192/2009 i ndryshuar;
- » **124** vendime të marra sipas Kodit Penal;
- » **4** vendime sipas Aktit Normativ (OFL), nr.1 datë 31.01.2020 “ *Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike*”;
- » **2** Revokime.

2. Mbi takimet e Komitetit Ndërinstitucional për Masat kundër Krimit të Organizuar

Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar, është ngritur dhe funksionon, sipas Ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar. Ky komitet përbëhet nga tetë anëtarë, të propozuar respektivisht nga Ministri i Financave, Ministri i Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm, ministri që mbulon çështjet e rendit publik, ministri që mbulon çështjet sociale, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, Kryetari i Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor dhe përfaqësuesi i ASHK-së. Në veprimtaritë e komitetit mund të ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësues të institucioneve publike ose organizatave të tjera, vendase a të huaja, veprimtarë në fusha me interes për zbatimin e këtij ligji. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara i raporton, të paktën një herë në tre muaj, komitetit për veprimtarinë e saj. Sipas mbledhjeve të thirrura për vitin 2024 të KNEMKKO, janë marrë në total 34 vendime në lidhje me administrimin e pasurive të sekuestruara/ konfiskuara, në përfitim në institucioneve të ndryshme, të cilët kanë paraqitur paraprakisht kërkesat e tyre pranë AAPSK-së.

Proceset gjyqësore me palë AAPSK

Përfaqësimi ligjor i institucionit kur thirret si palë në gjykim, realizohet në nivel institucional, nëpërmjet specialistëve të Sektorit të Marrëdhënieve me Institucionet dhe Çështjet Juridike, të cilët ndjekin proceset gjyqësore që lidhen me veprimtarinë e AAPSK-së dhe proceset gjyqësore me objekt “Marrëdhëniet e Punës”. Për vitin 2024 janë trajtuar 22 çështje në proces gjyqësor.

NISMA RREGULLATORE DHE RITJE TRANSPARENCE

Në kuadër të rregullimit të marrëdhënieve të punës dhe organizimit të institucionit, gjatë vitit 2024 u hartua rregullorja e brendshme “Për organizimin e punës dhe funksionimin e brendshëm të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara”. Rregullorja u miratua me Urdhrin e Ministrit nr. 1, datë 07.01.2025.

Ky dokument rregullon:

- » marrëdhëniet e punës mes stafit sipas strukturës organizative të AAPSK-së;
- » detyrat, përgjegjësitë dhe mënyrën e administrimit të pasurive;
- » procedura administrative;
- » rregulla të përgjithshme;
- » masa disiplinore;
- » dokumentet zyrtare, hartimin e tyre dhe korrespondencat;
- » hyrje-dalje në agjenci dhe masat e sigurisë.

Gjithashtu është hartuar dhe miratuar Kodi i Etikës, sipas Urdhrit të Kryeadministratorit nr. 763 datë 15.11.2024 “Për miratimin e Kodit Etik të AAPSK-së”.

Për herë të parë, pas inventarizimit të të gjitha pasurive dhe një pune voluminoze është realizuar hartimi dhe publikimi i **katalogut të parë të pasurive të paluajtshme të konfiskuara që AAPSK ka në admintrim**. Ky katalog ka kontribuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e Agjencisë. Katalogu përmban një listë të detajuar të pasurive të konfiskuara me vendim gjykate të formës së prerë, duke përfshirë informacion të plotë mbi llojin, sipërfaqen, vendndodhjen dhe statusin aktual të tyre. Qëllimi kryesor i këtij publikimi është të sigurojë informimin e plotë të publikut dhe palëve të interesuara, sa i përket procesit të administrimit të pasurive të konfiskuara.

Gjithashtu, **AAPSK ka finalizuar në mars 2025 hartimin dhe publikimin e katalogut për pasurive të sekuestruara**. Katalogu është i disponueshëm në versionin online, në faqen zyrtare të AAPSK, e cila gjithashtu është dizenuar nga e para, për të ofruar më shumë informacion dhe transparencë për mediat dhe publikun.

Nisma për hartimin dhe publikimin e dy katalogëve u ndërmor nga Kryeadministratorja e AAPSK, znj. Risena Xhaja, e cila që në ditët e para në detyrë kërkoi inventarizimin e plotë të të gjitha pasurive dhe realizimin e dy botimeve të ndara, për pasuritë e konfiskuara dhe ato të sekuestruara. Për hartimin e dy botimeve u angazhuan të gjithë administratorët e pasurive për të kryer azhornimet e nevojshme të tyre, me foto apo dokumentacion tjetër shtesë, për të patur një pasqyrë të plotë të këtyre pasurive të paluajtshme.

AAPSK do të vijojë të publikojë edhe gjatë vitit 2025 një sërë materialesh, përfshirë manualët e praktikave të punës në AAPSK, që do të shërbejnë si udhëzues për të gjithë aktorët e përfshirë në proceset e sekuestrimit/konfiskimit të pasurive. Këto manuale nuk do të jenë vetëm në shërbim të stafit të AAPSK-së, por edhe të institucioneve të tjera, mungesa e të cilave përgjatë këtyre viteve ka sjellë mangësi në mënyrën se si duhet të merret në dorëzim dhe administrohet pasuria sipas vendimeve të gjykatave.

PROJEKTE TË TJERA QË MBËSHTESIN SHOQËRINË

1. "KE BUONO", projekti nga fondacioni ENGIM.
2. "KINFOLK COFFEE LIBRARY", projekti nga Fondacioni Arsimor Shqiptar.
3. "TOKA JONË", projekti nga ANRD dhe EU.
4. Rehabilitimi dhe fuqizimi social i viktimave të trafikimit përmes integritit dhe punësimit.
5. Fuqizimi i pozitës sociale dhe ekonomike të viktimave të trafikimit.
6. Përdorimi i aseteve të konfiskuara në shërbim të komunitetit.
7. Mbështetja e strukturave të policisë me mjete detare dhe tokësore.
8. Identifikimi i nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara, sigurimi i pajisjeve elektronike për të ndihmuar mësimin dhe plotësimin e nevojave të tyre specifike.

"KeBuono" është një pastiçeri sociale që zhvillon veprimtarinë e saj në një pasuri të konfiskuar nga krimi i organizuar në Fier. Ajo ofron një shumëllojshmëri produktesh pastiçerie, si dhe një seri aktivitetsesh integruese me fëmijë, adoleshentë, studentëve, gra dhe prindër, me qëllim formimin e një kulture të ligjshmërisë dhe kundër dhunës midis të rinjve. Trajnime të Formimit dhe Aftësimit Profesional u ofrohen të rinjve që janë ish të dënuar ose familjeve të të burgosurve aktualë që përballen me kushte të vështira të jetesës socio-ekonomike.



Nëpërmjet kombinimit të elementeve të shumëllojshëm dhe të ndryshëm siç është trajtimi i konfliktit shoqëror, punësimit të personave të cenueshëm dhe promovimit të vlerave dhe të drejtave brenda komunitetit, "KeBuono" ka kontribuar në kapërcimin e dyshimeve për ripërdorimin e pasurive të konfiskuara nga krimi i organizuar në Fier.

Disa nga rezultatet e arritura:

- » Katër (4) gra dhe vajza të rrezikuara apo viktima të krimit në jetën socio-ekonomike të komunitetit janë të punësuar;
- » Gjashtëmbëdhjetë (16) të rinj janë kualifikuar përmes Trajnimit të Formimit dhe Aftësimit Profesional nga të cilët 7 të rinj janë të punësuar;
- » Bashkëpunimi me nëntë (9) shkolla dhe qendra në Fier ka kontribuar për të përfshirë mbi 700 fëmijë në aktivitete integruese; 1000 të rinj informohen për çështje sociale me qëllim krijimin e një kulture të ligjshmërisë dhe mungesës së dhunës midis të rinjve;
- » Katër (4) fushata ndërgjegjësuere u organizuan për të promovuar kulturën rome, parandaluar abuzimin me alkoolin dhe drogat, duke përfshirë persona me nevoja personale, si edhe për të ndërgjegjësuar mbi dhunën e bazuar në gjini.

“Kafe Biblioteka KinFolk” është një iniciativë që synon të shndërrojë pasurinë e konfiskuar nga krimi i organizuar në qytetin e Durrësit në një mjedis të përshtatshëm dhe miqësor për të rinjtë, familjet e tyre dhe qytetarët dhe t'i angazhojë ata në aktivitete sociale, kulturore dhe arsimore. Projekti synon të rinjtë, duke i përfshirë ata në aktivitete sociale dhe kulturore që i mbajnë ata larg nga aktivitetet e paligjshme dhe bota e krimit.



“Kafe Biblioteka KinFolk” është një qendër multikulturore, që ofron një gamë të gjerë aktiviteteve siç janë trajnime, kurse aktrimi, lexim ndërsa pihet kafeja, grupe diskutimi, kurs shahu, kurs gjuhësh, shkollat verore dhe dimërore, etj.

Rezultatet pas një viti të zbatimit të projektit:

- » Një mjedis i rehatshëm në të cilin të rinjtë mund të punojnë, bashkëveprojnë dhe nxënë në mënyrë të rregullt;
- » Katër (4) të rinj të punësuar;
- » Mbi 150 të rinj dhe studentë marrin pjesë dhe përfshihen në aktivitete edukative, artistike dhe kulturore.

Në kuadër të projektit “**Toka Jonë**” financuar nga Bashkimi Europian dhe zbatuar nga COSV Albania, Adad Malore po zbaton nismën komunitare që ka në fokus ripërdorimin social të tokës në Shijak. Projekti është titulluar “Fermë Sociale, e Shëndetshme dhe e Qëndrueshme” dhe synon të aftësojë të rinjtë dhe anëtarët e komunitetit mbi fuqizimin social ekonomik në bujqësi, rritjen e kapaciteteve tekniko-profesionale, ngritjen e një ferme didaktike në lidhje me kultivimin e agrumeve. Gjatë Janarit është punuar në fermë dhe parcela është mbjellë me agrume. Në pemtore janë mbjellë tre lloje agrumesh dhe 6 varietete; limon (3 varietete), portokall (2 varietete) dhe mandarinë (1 varietet).



Në punët në fermën sociale janë angazhuar fermerët nga komuniteti i fshatit dhe më gjerë në Shijak. Krahas anagazhimit të komunitetit dhe fermerëve që kanë punuar në fermë është bërë trajnimi i tyre për teknologjinë e re të ngritjes së pemtoreve me agrume. Mbjellja e parcelës me agrume është bërë në kohë optimale, sipas kushteve teknike dhe me teknologji të re. Pemtorja e mbështetur nga projekti “Toka Jonë” do të shërbejë si model teknologjie të re, jo vetëm prodhuesve të zonës, por në Qarkun Durrës dhe më gjerë.

“TRADITA IME ARTIZANALE”, një prej ndërmarrjeve sociale e mbështetur nga BE:

- » Mbron dhe promovon trashëgiminë kulturore duke punësuar gra nga grupet më të cënueshme dhe të marginalizuara, veçanërisht ato nga zonat rurale;
- » Rikthen në dobi të shoqërisë, një pasuri të konfiskuar nga krimi i organizuar;
- » Forcon imazhin dhe integritetin e Agjencisë.

Në fokus të këtij projekti është mbështetja e grave dhe vajzave në nevojë, duke ruajtur në anën tjetër traditën tonë me prodhime artizanale. Përmes shembujve të tillë, përmbushet një nga qëllimet kryesore të ligjit mbi administrimin e pasurive të konfiskuara, që është rikthimi në komunitet i pasurive të fituara në mënyrë të jashtëligjshme.

Në këtë kuadër, bashkëpunimi me institucionet e pushtetit vendor, si në këtë rast me Bashkinë e Elbasanit, e më parë edhe në Sarandë, Fier e Durrës, por edhe me bizneset, organizatat e shoqërisë civile, mediat, është me rëndësi të posaçme, edhe për arsyen e thjeshtë se produktet e këtyre grave dhe vajzat, pra qilimat e bukur e të veçantë që ato prodhojnë, duhet të gjejnë një treg, në mënyrë që sipërmarrje të tilla të jenë sa më e suksesshme. Aksioni i përbashkët dërgon një mesazh të fuqishëm në luftën kundër veprimtarisë kriminale në Shqipëri: Pasuritë e konfiskuara, sado të mëdha apo të vogla, mund të përdoren për një kauzë të mirë shoqërore.



“Garazhi Social i Artizanatit në Sarandë (SCG Sarandë)” është një punishte zejtarie e fokusuar në prodhimin e punimeve prej guri. Është zbatuar në ambientet e një pasurie të konfiskuar në Sarandë. Lënda e parë e përdorur për zejet do të jetë gurë natyralë nga plazhi (shumëngjyrësh, i sheshtë, shkëmb, prej xhami, etj.) , që janë pikturuar, shpuar, gdhendur dhe punuar me tel, me qëllim për të krijuar punime të ndryshme dhe të gatshme për treg. Modelet e gurit janë të lidhura me trashëgiminë kulturore dhe folklorin, duke i bërë këto produkte unike, të vlefshme dhe konkurruese në tregun artizanal, në mënyrë që të sigurojnë të ardhura afatgjata.

Rezultatet pas një viti të zbatimit të projektit:

- » Pas një Trajnimi fillestar të Formimit dhe Aftësimit Profesional, janë punësuar tetë (8) gra dhe vajza që janë viktima ose janë të rrezikuara nga metodat e krimit të organizuar të tilla si trafikimi i qenieve njerëzore, prostitucioni i detyruar, abuzimi seksual dhe dhuna në familje. Trajnim mbi zejtarinë e gurëve. Saranda do të shërbejë si një platformë për aktivitete sociale (siç janë festivali i artizanatit, ekspozitat) dhe do të shndërrohet në një Qendër Sociale që mbështet integrimin e viktimave të trafikuar në jetën ekonomike dhe sociale të qytetit.

“Qendra e Shërbimit Social”

Në mbyllje të vitit 2024, së bashku me institucione të tjera ishim pranë grave dhe fëmijëve, viktimë të dhunës në familje, duke përcjellë një mesazh solidariteti dhe angazhimi të përbashkët për ta.

Falë bashkëpunimit mes dy ministrive, Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara ka siguruar mbështetje konkrete, duke dhuruar artikuj të ndryshëm për ata që janë më në nevojë, një iniciativë që synojmë ta kthejmë në traditë të përhershme çdo vit.

Dhurimet vijuan edhe për fëmijët e Shtëpisë së Foshnjes “Hana dhe Rozafa”, duke sjellë më shumë ngrohtësi në ditë të veçanta.



Qendra “Art dhe Aktivizëm”

Falë angazhimit të AAPSK dhe bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile, kjo pasuri është transformuar në një qendër kulturore që mbështet artistët e rinj, aktivistët dhe komunitetet vulnerabël.

Qendra shërben si një platformë për shprehje artistike dhe aktivizëm qytetar, duke ofruar trajnime, ekspozita dhe veprimtari ndërgjegjëse për të rinjtë dhe grupet e marginalizuara. Ky është vetëm një nga shumë projekte që po realizohen nga Agjencia me qëllim kthimin e pronave të konfiskuara në pasuri me ndikim social.



Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) po vijon të forcojë rolin e saj dhe bashkëpunimin me aktorë të ndryshëm, duke kthyer pasuritë e përfituara nga aktivitetet e paligjshme në mjete konkrete për zhvillim social dhe ekonomik. Këto pasuri, dikur simbole të paligjshmërisë dhe përfitimeve kriminale, sot po shndërrohen në burime të reja mundësish për komunitetet më në nevojë në vend.

Falë angazhimit të AAPSK dhe bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile, këto pasuri janë transformuar në qendra kulturore që mbështet artistët e rinj, aktivistët dhe komunitetet vulnerabël.

Më shumë projekte do të realizohen nga Agjencia me qëllim kthimin e pronave të konfiskuara në pasuri me ndikim social.

Është thelbësore që këto pasuri të mos mbeten thjesht asete të ngrira, por të shndërrohen në mundësi konkrete për komunitetin. Ripërdorimi social i tyre kontribuon jo vetëm në forcimin e shtetit të së drejtës, por edhe në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit tonë.

Aktualisht, AAPSK ka në administrim dhjetëra prona të konfiskuara, një pjesë e të cilave janë tashmë të dhëna për përdorim nga organizatat jofitimprurëse, institucionet publike dhe projektet sociale. Disa prej tyre janë kthyer në qendra trajnuese për të rinjtë, ambiente për qendra komunitare, bujtina për viktimat e dhunës në familje, si dhe sipërmarrje sociale që punësojnë persona nga grupet më të rrezikuara.

Modeli shqiptar i administrimit të pasurive të konfiskuara po përshtatet gjithnjë e më shumë me praktikën më të mira të Bashkimit Evropian, ku ky koncept i “përdorimit social” të aseteve kriminale është kthyer në një instrument të fuqishëm për rikuperimin e pasurive publike dhe forcimin e besimit të qytetarëve te institucionet.

Në vijim, AAPSK ka planifikuar të zgjerojë bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile dhe pushtetin lokal për të identifikuar nevojat specifike të komuniteteve dhe për t’iu përgjigjur atyre përmes vënies në dispozicion të pasurive të rikuperuara. Kjo qasje synon të forcojë solidaritetin social dhe të sjellë ndryshim të prekshëm në jetën e qytetarëve.

BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET LIGJZBATUESE

Në muajin dhjetor 2024, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara ka marrë në dorëzim 102 kontejnerët, të cilët u shkarkuan nga anija e ankoruar në Portin e Durrësit.

I gjithë procesi është realizuar përmes një plani të detajuar masash, edhe në zbatim të urdhrave të Prokurorisë Durrës për zbarkimin dhe ruajtjen e 102 kontenerëve të anijes “Moliva”, në një vend të sigurt, larg zonave të banuara, si edhe duke respektuar në mënyrë rigoroze kushtet e sigurisë fizike, mjedisore dhe shëndetësore.

Të përfshirë në planin e masave ishin një sërë institucionesh, ku përveç punonjësve të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, në operacion kanë marrë pjesë edhe Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit, Autoriteti Portual Durrës, Kapiteneria e Portit Durrës, Dogana Durrës, Drejtoria e Hetimit Doganor, si edhe Prokuroria e Durrësit.

Pas shkarkimit të kontejnerëve nga anija, ato janë transportuar në masa rigoroze sigurie në destinacionin final ku do të mbahen në monitorim dhe administrim nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara.

Çdo veprim është regjistruar dhe dokumentuar përmes procesverbaleve dhe kontejnerët janë kontrolluar, skanuar dhe verifikuar, që nga gjendja e tyre e jashtme, deri tek të gjithë elementët e tjerë të sigurisë.

PROCESI I INTEGRIMIT DHE REKOMANDIMET E INSTITUCIONEVE NDËRKOMBËTARE

AAPSK jep kontribut direkt në procesin e negociatave të Shqipërisë me Bashkimin Evropian dhe është e angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në kapitujt 23 dhe 24, si hallkë e vetme e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Brendshme. Tryezat dhe konferencat e përbashkëta vijnë për hartimin e progres raportit të ardhshëm 2025 të BE. Stafi i Agjencisë gjithashtu kontribuon në hartimin e raporteve statistikore, si edhe krijimin e databazës së nevojshme sipas kërkesave të ekspertëve të huaj të angazhuar në këtë proces.

Sa i përket, kontributit dhe rolit të Agjencisë në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, Sqipëria përfundoi në dhjetor 2023 publikimin e “Vlerësimit Kombëtarë të Riskut Për Pastrimin e Parave (PP), Financimin e Terrorizmit (FT) dhe Financimin e Përhapjes së Armëve të Shkatërrimit në Masë”.

Vendi ynë, nga 40 Rekomandimet Immediate të FATF, ka realizuar 37 rekomandime gjerësisht të plotësuara dhe të plotësuara (LC/C), 1 rekomandim ka qenë i paaplikueshëm (NA) në kohën e vlerësimit dhe 2 rekomandime pjesërisht të përbushura (PC) dhe në proces adresimi.

Vlerësimi i ardhshëm i vendit nga MONEYVAL do të fokusohet në dy fusha: efektivitetin dhe përputhshmërinë teknike bazuar në metodologjinë e FATF. Së bashku, këto dy fusha paraqesin një analizë të integruar të shkallës në të cilën vendi është në përputhje me Standardet e FATF dhe sa i suksesshëm është ai në mbajtjen e një sistemi të fortë PP/FT, siç kërkohet nga Rekomandimet e FATF.

Theksi i çdo vlerësimi është kryesisht në efektivitet. Një vend duhet të tregojë se, në përputhje me rreziqet ndaj të cilave është i ekspozuar, ka një kuadër efektiv për të mbrojtur sistemin financiar nga abuzimi.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e këtij procesi për vendin tonë, nivelin e jashtëzakonshëm të angazhimit që kërkon nga shumë institucione, deri tani janë realizuar disa ushtrime simuluese për një pjesë të konsiderueshme të Rezultateve Immediate (2, 3, 6, 7, 8, 10 dhe 11), me fokus kryesor vlerësimin paraprak të nivelit të arritjeve apo mangësive në fushat përkatëse.

Në këtë proces, AAPSK ka dhënë kontributin e saj përgjatë vitit 2024 në tryezat e përbashkëta, seminarët e zhvilluar, etj. Agjencia do të vazhdojë me seriozitet dhe përkushtim të jetë pjesë e këtij procesi, për përmbylljen me sukses të vlerësimit të Shqipërisë nga Moneyval.

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Rrjeti i Agjencive të Ballkanit për Menaxhimin e Aseteve (BAMIN) është një strukturë bashkëpunimi mes Agjencive të Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara në vendet e Ballkanit dhe më gjerë. Anëtarët themelues të tij përfshijnë agjencitë e Ballkanit Perëndimor, por rrjeti është i hapur për vëzhgues dhe anëtarë të asociuar nga e gjithë bota.

Aktualisht, Rrjeti BAMIN përbëhet nga 25 Zyra të Menaxhimit të Aseteve:

- » 9 me statusin e Anëtarit,
- » 14 me statusin e Vëzhguesit dhe
- » 2 me Statusin e Asociuar.

AAPSK është një prej vendeve anëtare të BAMIN.

Që nga viti 2020, rrjeti ka marrë mbështetje financiare nga OSBE. Gjithashtu në vitin 2024, BAMIN i është dhënë statusi i anëtarësimit si “Observer” në Rrjetin Ndër-Agjencior të Rimëkëmbjes së Aseteve Camden (CARIN). Në aktivitet e vitit 2024, ku dhe AAPSK ka qënë pjesë e tyre, rëndësi të veçantë kanë patur takimi i zhvilluar në Maqedoninë e Veriut, në shtator 2024, si edhe takimi i mbajtur në Bruksel.

Në datat 17-19 shtator, në Ohër, Maqedoni e Veriut u mbajt mbledhja vjetore e BAMIN, duke përfshirë seancën plenare vjetore të BAMIN dhe një seancë trajnimi praktik lidhur me menaxhimin efektiv të kryptoaseteve. Gjithashtu është organizuar një takim shumëpalësh në Bruksel mes vendeve anëtare pjesëmarrëse në BAMIN, ku ishte e pranishme edhe AAPSK, për të diskutuar dhe ndarë eksperiencë, duke përfituar edhe nga praktikat më të mira evropiane.

Në 3-mujorin e fundit të vitit 2024, AAPSK ka hartuar dhe dakordësuar termat e një marrëveshjeje bashkëpunimi me Agjencinë Kombëtare të Ukrainës (ARMA) për gjetjen, gjurmimin dhe menaxhimin e pasurive që rrjedhin nga korrupsioni dhe krime të tjera. Marrëveshja pritet të nënshkruhet gjatë vitit 2025 dhe pritet të forcojë më tej bashkëpunimi ndërkombëtar të AAPSK me autoritetet homologe, edhe si një rekomandim i lënë nga agjencitë dhe ekspertët ndërkombëtarë, në kuadër të luftimit të krimit të organizuar dhe shkëmbimit të praktikave dhe eksperiencave më të mira.

PRIORITETE DHE OBJEKTIVA PËR PERIUDHËN NË VAZHDIM

Mbështetur në zhvillimet e fundit, për periudhën në vazhdim, Agjencia synon të avancojë më tej, duke vendosur theksin në:

1. Riorganizimi i strukturës së brendshme, përmes angazhimit të punonjësve më të kualifikuar, në funksion të rritjes së eficiencës dhe mirëadministrimit;
2. Thellimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me institucionet publike;
3. Hartimi i procedurave standarde të operimit për të mbuluar të gjitha proceset;
4. Riinventarizimi i pasurive në administrim dhe plotësimi i bazës së të dhënave;
5. Rishikimi i Rregullores së Brendshme;
6. Zbatimi i Strategjisë së Transparencës;
7. Riformatimi i formateve raportuese për punën e administratorëve;
8. Vendosja e bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe rritja e kapaciteteve të stafit të Agjencisë.

Sa i përket projekteve dhe nismave me impakt social, fokusi i Agjencisë do të vijojë të jetë tek rritja e impaktit në shoqëri dhe përdorimi sa më eficient i pasurive të konfiskuara dhe sekuestruara. Në këtë kuadër, AAPSK synon:

1. Riinvestimi i asetëve të konfiskuara në mirëqenien publike;
2. Rritjen e buxhetit të Fondit të Veçantë, duke menaxhuar pasuritë në mënyrë sa më efikente;
3. Rritja e mëtejshme e transparencës dhe llogaridhënies në shpërndarjen e asetëve;
4. Mbështetja e institucioneve të zbatimit të ligjit dhe forcimi i kapaciteteve të tyre në luftën kundër krimit të organizuar;
5. Rishpërndarja e produkteve të konfiskuara në institucionet e shërbimit social, me synimin për të mbështetur fëmijët në nevojë.



